

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (Tekst i pastruar) ark. nr.01-4898/1 datë 22.11.2024, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2606/1 datë 18.6.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3325/4 datë 7.8.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e shtatë të mbajtur më 7.8.2025, miratoi sa vijon:

**Aktvendim  
për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, për shkak të shkeljes së nenit 50 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (RRMPM), në mënyrë që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, emetuar më 3 qershor 2025, para transmetimit të disa programeve të kategorisë së parë dhe të dytë, është aplikuar sinjal paralajmërues i gabuar për mbrojtjen e të miturve, i cili nuk është përcaktuar në Rregulloren për mbrojtjen e të miturve (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4898/1 datë 22.11.2024.

Shkelja në paragrafin 1 të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2606/1, datë 18.6.2025, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

2. URDHËROHET që SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Agjencia, në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave të Ligjit në fjalë, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 50 paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit nuk mund të transmetojnë ose të ofrojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, në veçanti programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të tepruar. Ofruesit e shërbimeve me kërkesë, duhet të ndërmarrin masat më të rrepta teknike për të siguruar që të miturit të mbrohen nga përmbajtje të dëmshme, siç është dhuna e tepruar dhe pornografia. Përveç programeve në paragrafin (1) të këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, sigurohen dhe nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele kështu që të miturit të mos mund në mënyrë të zakonshme t'i shikojnë ose t'i dëgjojnë. Kur programet transmetohen ose ritransmetohen në formë të pakoduar, ofruesi i shërbimit mediatik audiovizual është i detyruar para transmetimit të ofrojë paralajmërim akustik paraprak dhe mundësinë e njohjes me ndihmën e shenjave vizuale gjatë gjithë transmetimit të programeve (neni 50 paragrafi 3 të LSHMAAV).

Në nenin 20 të RRMPM është përshkruar mënyrën e aplikimit të sinjalistikës paralajmëruese. Në përputhje me paragrafin (1) të nenit të njëjtë para fillimit të programeve televizive përfshirë në nenin 19 të rregullores (Përmbajtje në të cilën aplikohen shenjat paralajmëruese), detyrimisht transmetohet sinjali

paralajmërues që korrespondon me kategorinë e programit që është kombinim i shenjës vizuale, tekstit paralajmërim verbal dhe akustik, dhe zgjat së paku 10 sekonda dhe zë së paku 1/4 e pjesës së dukshme në ekran.

Në nenin 21 të RRMPM (Pamja dhe përmbajtja e sinjalit paralajmërues), ndër të tjera, është përcaktuar se sinjali paralajmërues që aplikohet para, deri ose gjatë programeve nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale për programet e klasifikuara të kategorisë së dytë, duhet të shfaqet numri "8" dhe shenja "+", si dhe teksti i paralajmërimit: "Programe të kategorisë së dytë që nuk rekomandohen për fëmijë nën 8 vjeç. Rekomandohet mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari."

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia, përmes Sektorit për çështje programore, më 18 qershor 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, transmetuar më 3 qershor 2025, në nivel lokal, ku konstatoi shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të RRMPM.

Konkretisht, me mbikëqyrjen e rregullt programore të shërbimit programor televiziv të SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, transmetuar më 3 qershor 2025, në nivel lokal, u konstatua shkelje e nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të RRMPM. Në kundërshtim me nenet 20 dhe 21 të RRMPM (mënyra e aplikimit, pamja dhe përmbajtja e sinjalit paralajmërues), para transmetimit të disa programeve të kategorisë së parë dhe të dytë, është aplikuar sinjal paralajmërues i gabuar që nuk është përcaktuar në Rregullore. Kjo ka të bëjë me sinjalizimin në edicionet premierë të programeve me funksione të ndryshme mediatike të listuara në tabelat e përfshira në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr. 10-2606/1 datë 18.6.2025, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akvendimi si Shtojcë nr. 1. dhe në të cilin është specifikuar shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovës, më 19.6.2025, ka dërguar Shkresë me nr.ynë ark.10-2606/2 datë 19.6.2025, me të cilën dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-2606/1 datë 18.6.2025, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklarament me shkrim për shkeljen e kryer të LSHMAAV dhe RRMPM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 23.6.2025. Në afatin e parashikuar SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, drejtuar Agjencisë nuk dorëzoi Deklarim me shkrim. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 7.8.2025, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë t'i shqiptohet masë – paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 20 dhe 21 të RRMPM, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Teksti i pastruar), Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2606/1 datë 18.6.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3325/4 datë 7.8.2025, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Akvendimi, Këshilli i Agjencisë, në seancën e shtatë mbajtur më 7.8.2025, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron SHTR TV KANAL FESTA SHPKNJP Kumanovë, dhe urdhëron, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitatë e LSHMAAV dhe RRMPM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në përputhje me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

#### **Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr. 10-2606/1 datë 18.6.2025 .

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Mr. Sasho STEFANOVSKI**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.